

Agjencia e Administrimit Kolektiv

## **FABER COLLECTIVE PHONOGram**

Rregullorja e Shperndarjes

v. 1

[Dite 05 Janar 2022]

**Përbajtja:**

1. Identifikimi i veprave te fonogramit	3
2. Shperndarja ne baze te listave te perdonimit me informacione sasije	3
3. Shperndarja ne baze te listave te perdonimit pa informacione sasije	4
4. Raportimi dhe eksekutimi shperndarjes	4

**Baza Ligjore:**

- Ligj nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to” (**Ligji per te Drejten e Autorit**)
- Vendim i Keshillit Kombtar per te Drejten e Autorit nr. 3, date 04.08.2017 “*Per Miratimin e Metodologjise dhe Mases se Tarifave te Shperblimit te Veprave te Mbrojtura nga e Drejta e Autorit ne Sistemin e Administrimit Kolektiv*”
- Statuti i Agjencise

## **1. Identifikimi i veprave te fonogramit**

- 1.1 Cdo anetare do perdori sistemin e shoqates, te licensuar nga Shoqata per te hedhur fiksimin e tingujve te cdo vepre te cilën ai/ajo e ka fiksuar ne njerun nga keto formatet: AAC, WAVE, MP3, OGG ose digital  
Per te hedhur nje material eshte e domosdoshme qe anetari te jete i pajisur me njesmartphone ose nje kompjuter.
- 1.2 Gjate hedhjes se materialit duhen specifikuar nga anetari pjeset te cilat nuk jane origjinale, si psh. sekuenca qe permajne nje fiksim te nje tjeter vepre.
- 1.3 Pasi materiali eshte dorezuar ne sistem ai do te krahasohet ne menyre automatike me materiale te tjera te njoitura, dhe ne rast se do kete konflikte me fiksime te tungujve nga te tjere anetare ose nga producent fonogramesh te tjere edhe jo-anetare, anetari do te informohet nga punenonjesit e Shoqates per sqarimin e atyre sekuencave. Deri ne sqarimin e sekuencave te ardhurat e gjeneruara nga sekuenca ne konflikt do te mblidhen ne nje fonde te vecante dhe nuk do ti paguhen anetarit. Ne rast se konflikti nuk zgjidhet me mareveshje, ai duhet te zgjidhet nga nje Gjyakte kompetete e cila duhet te vendosi ne lidhje me sekuenca konfliktuale.
- 1.4 Pervec materialit anetari duhet te vendosi ne dispozicion keto te dhena pershkruese ne lidhje me secilen vepor fonogrami:
- titull ose pershkrim i vepres (e detyrueshme)
  - data e publikimit te pare (e detyrueshme)
  - data e fiksimit (opcionale)

## **2. Shperndarja ne baze te listave te perdonimit me informacione sasie**

- 2.1 Listat e perdonimit me informacione sasie kane informacione te sakta per veprat qe jane perdonur me titull dhe kod ISRC ne rast se eshte i identifikueshem.
- 2.2 Do te kryhet kthimi i informacionit sasior ne ore transmetimi si emerues i perbashket me piken tre te kesaj rregulloreje.
- 2.3 Do te kryhet perllogaritja ne perqindje e peshes specifike ne ore te perdonimit te cdo vepre dhe kjo perqindje perben ndarjen e shumes se grumbulluar nga e drejta e autorit.

### **3. Shperndarja ne baze te listave te perdonimit pa informacione sasie**

3.1 Ne rast se te ardhurat jane gjeneruar pa informacion sasie, atehere do te merret nje sasi referues per tregun, e cila do te gjenerohet ne baze te shikueshmerise te gjeneruara nga fonogramet e anetareve ne platformen YouTube

3.2 Perdonimi do te perllogaritet ne baze oreve te degjaura te fonogramit. Do te merren ne konsiderate vetem oret nga teritori Shqipetar.

Oret e seciles veper te perdonura do te krahasohen me veprat e identifikuara dhe sasia e minutave do perdoret si indikator per te perllogaritur nje perqindje reference te perdonimit te veprave.

Shembull:

Mbajtesi i te drejtave nr. 1 ka gjeneruar 1 million ore, Mbajtesi i te drejtave nr. 2 ka gjeneruar 3 million ore dhe Mbajtesi i te drejtave nr. 3 ka gjeneruar 4 million ore. Mbajtesi i te drejtave nr. 1 i takojne 10%, Mbajtesi i te drejtave nr. 2 i takojne 30% dhe Mbajtesi i te drejtave nr. 3 i takojne 60% te te ardhurave.

### **4. Raportimi dhe eksekutimi shperndarjes**

4.1 Raportimi do te behet ne vjetore me ane te emailit kundrejt cdo mbajtesi te te drejtave. Emaili do te kete te bashkengjitur nje dokument sqarues me te gjitha perdonimet dhe shperblimet e gjeneruara nga veprat perkatese. Persa i perket perdonimit pa informacion sasije emaili do te permbar nje raport ne sqarues ne baze te ciles jane llogaritur perqindjet referenciale duke perfshire minutat e perdonimit te seciles veper qe eshte marr parasysh per perllogaritjen e perqindjes referenciale.

4.2 Shperndarja e te ardhurave te gjeneruara nga e drejta e autorit do te kryhet per te gjitha veprat e identifikuara nga sistemi i monitorimit ku perfshihen anetar dhe jo anetar sic e parashikon ligji ne fuqi per te drejten e autorit